



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:190974
Datë: 01.03.2024
Numri i dokumentit: 05397305

2021:190975

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Q.V. nga Vitia kundër të paditurit S.J.I. me adresë në rr. ... - Komuna Shtime, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, me vlerë të kontestit 257,52€, pas mbajtjes së seancës përgatitore të datës 26.02.2024 në prezencë të autorizuarit të paditësit mori ndërsa me datë 01.03.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET se është tërhequr padia me numër 2021:190975, e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a me seli në Prishtinë kundër të paditurit S.J.I. me adresë në rr. - Komuna Shtime, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, me vlerë të kontestit 257,52€.

II. OBLIGOHET i padituri S.J.I. që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumë prej 20,00€ në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padi, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë më dt. 27.08.2021 kundër të paditurit me objekt kontesti kompensim i dëmit material, me vlerë të kontestit 257,52€ .

Paditësi përmes të autorizuarit të tij Q.V. nga Vitia, në seancën përgatitore të datës 26.02.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë në këtë çështje juridike kontestuese sepse i padituri e ka përmbushur kompensimin e dëmit në tërësi ndaj paditësit. Paditësi i ka kërkuar shpenzimet e

procedurës prej 20,00€ në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padi. Ndërsa i padituri edhe pse ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, nuk kishte prezentuar në seancë.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktvendimi konform nenit 454 të LPK sepse i padituri ishte shkaktar i inicimit të këtij kontesti ndërsa lartësinë e taksës gjyqësore e përcaktoi bazuar në Udhëzimin Administrativ të KGJK-së për unifikimin e taksave gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 01.03.2024

Gj y q t a r i
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.